



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 28, datë 14.02.2025

PËR

**“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONI PËR
PROKURORIN ENI ÇULLI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
3. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
5. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
9. Zotit Erind GERMENJI	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 13.02.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar dhe në nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin Eni Çulli”

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 149/a, germa “e” dhe 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;



2. Neni 9 i ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;*
3. Nenet 164, pika 8 dhe 189, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;*
4. Neni 8 i Rregullores *“Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”.*

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim relacioni shoqërues nr. 222 prot., datë 06.02.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me relator zotin Zeqir Hoda, si dhe referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, ai shqyrton, miraton ose refuzon kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.
2. Në datë 24.01.2025, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është regjistruar kërkesa me objekt: *“Kërkesë për miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni”* (regjistruar me nr. 136, datë 24.01.2025), e magjistratit Eni Çulli, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
3. Referuar përmbajtjes së kësaj kërkesë, si dhe dokumentacionit shoqërues, magjistrati Eni Çulli kërkon nga Këshilli, lejimin për të ushtruar veprimtari jashtë funksionit si pedagog i jashtëm për lëndën *“E drejta e procedurës penale”*, në semestrin e dytë, Viti i II-të, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë.
4. Ky angazhim fillon në datë 31.01.2025 dhe përfundon në muajin Qershor 2025, në përfundim të vitit akademik 2024-2025. Kjo veprimtari do të përmbushet gjatë/jashtë orarit zyrtar për një total prej 4 orësh mësimi në javë që do të zhvillohen vetëm ditën e premte, në pjesën e dytë të ditës.
5. Kërkuesi angazhohet me përgjegjësi të lartë se, ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksioni, në asnjë rast nuk do të përbëjë shkak për shmangien e detyrimit për t’u paraqitur në seancë gjyqësore, në vendin e ngjarjes apo në çdo veprim të ngutshëm që nevojitet të kryhet për shkak të funksionit të prokurorit.
6. Sipas kërkesës, shpërblimi për këtë veprimtari është në shumën 705 lekë për çdo orë mësimi 60 minutëshe, në përputhje me tarifat e miratuara me VKM-në nr. 748, datë 11.06.2009, *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë” i ndryshuar.*
7. Kërkesa shoqërohet nga e-mail-i i datës 24.01.2025, i përgjegjëses së grupit kërkimor-shkencor, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, në të cilin thuhet se:

"I nderuar zoti Çulli. Ju njoftojmë se në bazë të Vendimit të Senatit nr. 112, datë 20.01.2025 të Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë, jeni zgjedhur si pedagog i jashtëm për lëndën "E drejta procedurale penale"...."

8. Nga shkresa datë 23.01.2025, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, që shoqëron kërkesën rezulton se:

"Bazuar në kërkesën e bërë nga prokurori Eni Çulli lidhur me ngarkesën e punës rezulton se aktualisht ky prokuror ka në hetim/ndjekje penale rreth 150 çështje penale. Ngarkesa e këtij prokurori i cili ushtron dhe detyrën e drejtuesit të seksionit për të mitur është brenda mesatares së ngarkesës që kanë dhe prokurorët e tjerë."

9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit konstaton se, prokurori Eni Çulli nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.

10. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën e kërkuar nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së tij.

Veprimtaria jashtë funksionit në rastin konkret:

- është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
- nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohej sipas ligjit.
- nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
- nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.

11. Shpërblimi për veprimtarinë jashtë funksionit i parashikuar për angazhimin e kërkuar nuk tejkalon rregullat e zakonshme të tregut dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konstaton se:

12. Në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, duhet të miratohet veprimtaria jashtë funksionit për prokurorin Eni Çulli, si pedagog i jashtëm për lëndën "E drejta e procedurës penale", në semestrin e dytë, Viti i II-të, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, germa "e", 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"* i ndryshuar, nenet 6 dhe 8 të Rregullores *"Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve"*, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:



1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Eni Çulli si pedagog i jashtëm për lëndën “E drejta e procedurës penale”, në semestrin e dytë, Viti i II-të, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë.
2. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe prokurori Eni Çulli.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 14.02.2025.

KRYETAR

Mirela Bogdani

